



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.11.2019, ora 12:30

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me përfaqësues të institucioneve shtetërore, partnerëve ndërkombëtarë dhe operatorëve medietikë, në kuadër të shqyrtimit të: projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97, datë 4.3.2013, “Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9918 , datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Të ftuar :

Artan Syziu – përgjegjës sektori në Ministrinë e Drejtësisë

Elsa Gjini - specialiste në Ministrinë e Drejtësisë

Enea Karakaci – Drejtor Juridik në Ministrinë e Energjetikës

Irena Malolli – Drejtoreshë e Telekomunikacionit në Ministrinë e Energjetikës

Monika Bilate – zëvendëskryetare e delegacionit të BE-së në Shqipëri

Deirdre Kevin – eksperte ndërkombëtare e pavarur nga zyra e Këshillit të Europës

Olsi Dekovi – Zëvendës kreu i Këshillit të Europës në Tiranë

Enisa Karaxho – përfaqësuese e projektit “Lirisë së Shprehjes të KiE dhe BE-së”

Adelina Albrahimi – përkthyes

Gentian Sala – Kryetar i AMA-s

Sara Xhumbari – Drejtore në Drejtorinë Juridike dhe Licencave të AMA-s

Irina Radu – këshilltare e lartë për Zhvillimin e Medias, OSBE në Shqipëri

Elira Çanga – Këshilltare Vendore për Median, OSBE-së në Shqipëri

Mimoza Gjika – përkthyesë

Fioralba Shkodra – shefe e zyrës së UNDP-së

Guri Daco – këshilltare e zyrës për Çështjet e Komunikimit në UNDP

Emiljano Kaziaj – drejtues i ekipit të medias në projektin “*Justice for all*” nga USAID-

i

Ada Heqimi – koordinatorë e projektit

Erjona Canaj – Komisionerë e Avokatit të Popullit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëdita të gjithëve!

Ju kërkoj ndjesë për vonesën, sepse me kolegët e mi të Komisionit të Ligjeve kishim një angazhim, pjesa e maxhorancës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sa më e madhe është çështja e vlerësimit, zoti Gjoni... Gjithsesi u kërkoj ndjesë të pranishmëve për këtë vonesë.

Fillojmë mbledhjen e komisionit për ditën e sotme, sepse kuorumi është dhe na lejon për të vazhduar me rendin e ditës. Në një mbledhje më përpara të Komisionit të Ligjeve e kemi bërë prezantimin në parim të paketës së projektligjeve, që e kemi quajtur “paketa antishpifje”, pra projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97, datë 04.03.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi. Relatorët këtyre projektligjeve janë koleget Vasilika Hysi dhe Klotilda Bushka.

Nisur nga rëndësia dhe sensibiliteti publik që kanë këto dy projektligje, Komisioni i Ligjeve ka miratuar një kalendar të posaçëm për shqyrtimin e këtyre dy projektligjeve, i cili është publik në faqen zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë. Pra, është bërë prezantimi në parim i këtyre dy projektligjeve dhe, sipas kalendarit të posaçëm që kemi miratuar, do të zhvillojmë disa dëgjesa publike me grupet e interesit, më pas do ta miratojmë në parim dhe do të bëjmë shqyrtimin nen për nen të të dy projektligjeve. Kjo jo vetëm për të pasur në variantin final dy projektligje, të cilat unë jam i bindur që do të jenë në standardet më të mira europiane, por që t’i shërbejnë qëllimit për të cilin ato kanë ardhur në parlament, pra që kanë të bëjnë me një ekuilibër të balancave të të drejtave dhe detyrimeve që kemi në një shoqëri demokratike dhe të hapur, duke garantuar nga njëra anë të drejtën e informimit, kredibilitetin e medieve dhe lirinë e tyre, por nga ana tjetër edhe liritë e të drejtat e njeriut në një shoqëri të hapur, për shkak edhe të zhvillimit të teknologjisë.

Pa humbur kohë sot do ta hapim siparin e dëgjesave publike për të dyja këto projektligje, me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, partnerët ndërkombëtarë dhe operatët medietikë.

Nga Ministria e Drejtësisë kanë konfirmuar pjesëmarrjen zoti Artan Syziu dhe zonja Elsa Gjini, nga Ministria e Energjetikës kemi zotin Enea Karakaçi, drejtor juridik, dhe zonjën

Irena Malolli, drejtoreshë e telekomunikacionit, nga delegacioni i BE-së kemi zonjën Monika Bilate, zëvendëskryetare, nga zyra e Këshillit të Europës edhe kemi zonjën Deirdre Kevin, eksperte e pavarur, zotin Olsi Dekovi, zëvendëskreu i Këshillit të Europës në Tiranë, zonja Enisa Karaxho dhe zonjën Adelina Albrahimi, që është stafi i zyrës së Europës në Tiranë, përkthyesë. Nga AMA është prezent zoti Gentian Sala, kryetar i AMA-s, dhe zonja Sara Xhumbari, drejtore në Drejtorinë Juridike dhe Licencat. Si përfaqësuese e OSBE-së në Shqipëri kemi zonjën Irina Radu, këshilltare e lartë për Zhvillimin e Medias dhe zonjën Elira Çanga këshilltare vendore për Median dhe përkthyesit që e shoqërojnë. Nga UNDP-ja kemi të ftuar zonjën Fioralba Shkodra, shefe e zyrës, zonjën Guri Daco, këshilltare e zyrës për Çështjet e Komunikimit. Nga USAID-i kemi zotin Emiljano Kaziaj, drejtues i ekipit të medeas, projekti “Justice for all” dhe zonjën Ada Heqimi, koordinatorë e projektit. Nga Avokati i Popullit kemi zonjën Ejona Canaj, komisionere.

Ju kërkoh ndjesë nëse kam harruar t’i lexoj emrin ndonjërit që është prezent në këtë sallë, por për të qenë të hapur deri në fund kushdo që e merr fjalën, për të dhënë mendimin e vet për këto dy projektligje, të prezantohet.

Mbledhja do të regjistrohet në audio dhe do të zbardhet çdo gjë që do të thuhet këtu dhe do të botohet në faqen zyrtare të Komisionit të Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë, pra çdo gjë do të jetë transparente.

Fjalën për pyetje e ka kërkuar zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Duke marrë në konsideratë rëndësinë e diskutimit dhe dëgjësive për të dyja projektligjet, që kanë rëndësi shumë të madhe për të ardhmen e medieve në Shqipëri, jam kurioz të di se ku janë mediet sot? Unë dua të qartësohem nëse mediat janë njoftuar, sepse është hera e parë që shikoj në Komisionin e Ligjeve që nuk e kemi të pranishëm përfaqësues të kanaleve medietike televizive. Pra thjeshtë dua ta qartësoj këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm një, por më duket e çuditshme mungesa e medies sot.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Për ta shuar kureshtjen dhe çudinë tënde, zoti Gjoni, mediet janë njoftuar për këtë seancë dëgjimore, ashtu siç është praktika e të gjitha mbledhjeve që zhvillon Komisioni i Ligjeve. Në prezantimin në parim të këtyre dy projektligjeve kishte një interes më të madh të medive, por fakti që nuk janë këtu të gjithë, ndoshta do të vijnë më vonë, nuk e zbeh aspak rëndësinë e kësaj mbledhjeje.

Dua ta filloj pa humbur kohë këtë seancë dëgjimore dhe ftoj përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, më pas me radhë partnerët ndërkombëtarë dhe operatorët medietikë

ta marrin fjalën sipas radhës. Kush e dëshiron fjalën për t'u shprehur për të këto dy projektligje, të kërkojë fjalën dhe të prezantohet.

Nuk keni përse të prisni njëri-tjetrin se kush do të shprehet, gjithsecili të shpreh mendimin, sepse jemi të hapur. Dëgjuesat do t'i bëjmë deri në fund, pra jo vetëm sot, por deri sa të marrim edhe opinionet e fundit për këto projektligje. Kush e do fjalën? Nëse nuk keni gjë për të shtuar, atëherë i bie që të dyja projektligjet që janë hartuar janë perfekt.

Po, ju lutem.

Monika Bilate – Përsëritje të gjithëve! Unë quhem Monika Bilate dhe jam zëvendëshefe e delegacionit europian në Tiranë. Ne menduam që ekspertët do të bënin një përmbledhje të ligjit, por megjithatë përderisa nuk po e merr njeri fjalën, atëherë po i japim ne komentet lidhur me projektligjet në fjalë.

Së pari, faleminderit shumë për ftesën dhe për konsultimin!

Për sa u takon dy projektligjeve, i pari ka të bëjë me shërbimet audiovizive të medias dhe projektligji i dytë ka të bëjë me komunikimin elektronik. Siç e dini, ky takim është pjesë e një zinxhiri të gjatë komunikimesh që kemi pasur me autoritetet shqiptare, për sa i takon versioneve të ndryshme të prodhuara për dy projektligjet në fjalë ose për paketën legislative që na ka mbledhur sot. Gjatë diskutimeve për versionet e mëparshme të projektligjit Komisioni ka dërguar komentet e veta për sa i takon pjesës së harmonizimit të projektlegjislacionit shqiptar me *acquis-n* përkatëse të Bashkimit Europian, gjithashtu, lidhur edhe me respektimin e të drejtave themelore, në kuadrin e lirisë së shprehjes dhe të standardeve të medias.

Komentet e para të Komisionit Europian janë depozituar në datën 20 shkurt të vitit 2019 dhe lidhen me përputhshmërinë e ndryshimeve të propozuara me direktivën për shërbimet audiovizive të Bashkimit Europian, me direktivën e tregtisë elektronike, po ashtu me politikën e komisionit për të trajtuar dezinformimin. Ndërkohë që u dërgua një version tjetër i paketës. Në qershor ky version i është dërguar formalisht parlamentit dhe më pas, i njëjti version, na është dërguar edhe ne, me datë 22 qershor, i cili më tej u rishikua dhe u analizua nga shërbimet e komisionit. Në fund të procesit të analizës u konfirmua që shqetësimet e mëparshme madhore të lidhura me *acquis-n* apo me legjislacionin europian dukej se ishin trajtuar.

Në të njëjtën kohë, më lejoni ta bëj të qartë që Komisioni Europian ka theksuar që çështjet e lidhura në mënyrë të plotë me pjesën e harmonizimit me *acquis-n* specifike të Bashkimit Europian janë trajtuar, por ende duhet të sigurohet përputhshmëria e plotë e projektligjit me standardet e lirisë së shprehjes.

Siç e kemi bërë të qartë edhe në komentet tona të mëparshme dhe në deklaratat publike, ndërkohë që ndajmë shqetësimet e autoriteteve shqiptare lidhur me dezinformimin. Komisioni

rekomandon qasje, të cilat janë pak më të rënda se qasjet e propozuara, mbështetur edhe në qasjen vetrregullatore.

Këtu specifikisht i referohem komunikatës për rigjurmimin e dezinformimit online. Në këtë aspekt dua të them se standardet europiane dhe ato ndërkombëtare në fushën e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias janë parësore, janë kyçe, janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e një medieje të fortë dhe pluraliste dhe, për pasojë, duhen të merren parasysh nga autoritetet shqiptare. Në kuadrin e asaj çfarë thashë më sipër, ne kemi mobilizuar, nëpërmjet fondeve të BE-së, një ekspertizë shtesë në kuadër të Këshillit të Europës për të rishikuar paketën legislative dhe ju bëjmë thirrje që t'i përdorni përfitimet e kësaj ekspertize.

Sot ne kemi të pranishëm ekspertizën e parë, gjithashtu, kemi edhe opinionin e parë të ekspertes nga projekti i përbashkët i BE-së dhe Këshillit të Europës për projektligjet në fjalë, komente të cilat ajo do t'i ndajë me ne më vonë. Po ashtu, ne ndajmë edhe shqetësimet e ngritura nga organizatat e tjera ndërkombëtare që punojnë dhe janë aktive në këtë fushë, veçanërisht shqetësimet e ngritura nga OSBE-ja të lidhura, ndër të tjera, edhe me mungesën e sigurisë juridike dhe zgjerimin e fushës së kompetencave të Autoriteti Medietik Audioviziv për të përfshirë edhe rregullimin e medias online, gjë e cila mund të ketë efekt negativ në lirinë e shprehjes. Po ashtu, ne na është vënë në dispozicion versioni përfundimtar, i cili u është dërguar edhe shërbimeve përkatëse në Bruksel, pra ekspertëve tanë në drejtorinë e përgjithshme kompetente, të cilët do të analizojnë më tej mendimet e bëra prej jush. Ne do t'i ndajmë mendimet e tyre për draftin e tretë në momentin që do të na vijë këto mendime.

Në përfundim, më lejon të them se ne do të vazhdojmë të inkurajojmë autoritet shqiptare që të ndjekin procesin e konsultimit me komunitetin e medieve për projektligjet në fjalë, duke marrë parasysh përvojën e tyre, si dhe përvojën e aktorëve të tjerë ndërkombëtarë, duke siguruar në këtë mënyrë një ndikim pozitiv në të ardhmen e paketës legislative për lirinë e shprehjes në Shqipëri.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Bilate!

Natyrisht, ne mirëpresim çdo ekspertizë që do të kemi në dispozicion nga delegacioni i BE-së. Ju të gjithë jeni të ftuar, pra jo vetëm zyra juaj, por edhe përfaqësuesit e tjerë, të cilët janë sot prezent në këtë dëgjese në Komisionin e Ligjeve, që përpos ndarjes së mendimeve në këtë mbledhje, të cilat do të regjistrohen në audio, dhe të lutur që t'i depozitoni edhe me shkrim sot, por edhe në ditët në vazhdim në sekretarinë e Komisionit të Ligjeve, në mënyrë që relatorët e këtyre dy projektligjeve, zonja Bushka dhe zonja Hysi, në përfundim të këtyre dëgjesave, të kenë në dispozicion të gjitha opinionet e ekspertëve, qoftë të ekspertëve

ndërkombëtarë, qoftë edhe të grupeve të interesit apo edhe të ekspertëve vendas. Natyrisht, unë e thashë, në prezantimin që u bë në seancën e kaluar për të dyja draftet, se draftet fillestare në momentin e depozitimit në Kuvend, sipas procedurës parlamentare dhe Rregullores së Kuvendit, janë të publikuara në faqen e Kuvendit ditën kur janë depozituar dhe i janë njoftuar seancës plenare. Sigurisht, ka pasur edhe dy drafte të tjera të përmirësuara si rezultat i takimeve ndërmjet grupit të punës dhe ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendas dhe këto dy drafte u janë vënë në dispozicion grupeve të interesit, por edhe juve si zyrë.

Unë do t'ju ftoja që të gjitha opinionet apo mendimet, që do të jepni në nivel ekspertize të jenë mbi këto dy drafte që ne ju kemi dërguar herën e fundit, pra draftin që ju kemi dërguar herën e fundit, që është një variant i përditësuar dhe i dakordësuar në shumicën dërrmuese edhe me ekspertizën e OSBE-së. E kam thënë dhe dua ta përsëris, nisur edhe nga disa keqkuptime, që pas mbledhjes së parë të Komisionit të Ligjeve, ku u prezantua në parim paketa, se absolutisht ne, si Komisioni i Ligjeve dhe si Kuvend, jemi të hapur për çdo lloj ekspertize në funksion të përmirësimit të ligjeve. Interesi ynë dhe interesi i publikut është që kjo paketë, të cilën do ta miratojmë, të jetë në përputhje me legjislacionin e BE-së, gjë të cilën ju sapo e theksuat, por edhe me standardet më të mira të lirisë së medieve. Fjalën e ka kërkuar ekspertja e Këshillit të Europës.

Ju lutem, merreni fjalën dhe prezantohuni.

Irina Radu – Unë quhem Irina Radu dhe jam këtu si përfaqësuese e OSBE-së. Ne kemi pasur përpara një rend dite dhe do të doja që ta respektonim. Pra, unë dua të them disa fjalë në përputhje me rendin e ditës.

Ulsi Manja - Po, mund të vazhdoni!

Irina Radu – Për shkak të pozicionit që ne kemi, është e lehtë që fjalët tona të përsëriten, por ndonjëherë ato keqinterpretohen. Është e lehtë kur thuhet se OSBE-ja ka mbështetur apo ka ndihmuar në përmirësimin e një projektligji, por nuk është e njëjta gjë kur thuhet se OSBE-ja e ka miratuar atë ligj.

OSBE-ja ka një institucion të posaçëm për lirinë e medies, e cili quhet Përfaqësuesi për Lirinë e Medies. Ky institucion është përfshirë që në fillim të punës dhe kjo është bërë me kërkesë të Kryeministrit shqiptar. Në fakt, ky është edhe roli ynë që të ndihmojnë qeverinë sa herë që kjo gjë na kërkohet.

Për këtë arsye Përfaqësuesi për Lirinë e Medies në OSBE, që në momentin kur mori kërkesën e vlerësoi të rëndësishme dhe kontrakttoi dy ekspertë. Këta dy ekspertë kanë dhënë opinionin e tyre të botuara në muajin korrik. Besoj se ju të gjithë i keni lexuar, por që nga ajo kohë ka pasur ndryshime të tjera. Këtu shtohet pyetja: sa drafte të tjera ka dhe sa ndryshime do

të bëhen? Të gjithë ekspertët që merren me ligje e dinë se në momentin që ndryshohet qoftë edhe një fjalë e vetme në ligj kemi të bëjmë me një draft të ri.

Pra, duhet ta themi se drafti ka pësuar përmirësime nga drafti, që u botua si varianti i parë në dhjetor deri te ky që shpresojmë të jetë drafti i momentit. Megjithatë, ne sërish shpresojmë që ky draft të përmirësohet më shumë. Ka pasur shumë ndryshime, të cilat ne i kemi mbajtur shënim dhe ju falënderojmë për këtë, megjithatë unë, si gazetarë, sepse profesioni im është gazetarë, kam vënë re se njerëzit fyhen nga ato që thuhet në medie. Çështja është: a mundemi ne që të vendosim disa rregulla, në mënyrë që edhe mediet të mos fyhet nga ato që thonë njerëzit për to? Pra, të gjendet një balancë midis asaj që thuhet dhe atyre që e thonë. Megjithatë, pa shkuar në detaje, dua të vë në dukje se ne ende vazhdojmë të jemi të shqetësuar që AMA-s i është lënë një rol kaq i madh në media, pasi do të donim që këtë rol të fortë ta kishte drejtësia dhe të mos zëvendësohej në asnjë mënyrë nga AMA, duke qenë gjykatat ato që i marrin vendimet. Vëmë re se gjrobat janë ulur, jo aq sa duhet, por vazhdojnë të jenë joproporcionale. Siç e tha edhe kryetari, sigurisht që ne do t'ua dërgojmë me shkrim të gjitha opinionet tona. E kuptojmë që ky është thjesht një diskutim dhe ju falënderojmë për të gjitha ato që i keni marrë në konsideratë dhe shpresojmë se do të vazhdoni t'i merrni parasysh kontributet tona. Gjithashtu, do të donim që ky diskutim dhe këto kontribute të zgjeroheshin edhe më tej, duke përfshirë edhe fushën e dekriminalizimit dhe të pronësisë në media dhe ndoshta këtu fshihet edhe përgjigjja e pyetjes: pse nuk ka shumë media të pranishme që të japin opinionin e tyre. Unë mendoj se ndoshta ata kanë frikë, por, në fakt, frikë duhet të kenë ata që shpifin dhe jo gazetarët dhe mediet korrekte.

Nuk po zgjatem më shumë se ka shumë të tjerë që duan ta marrin fjalën në këtë diskutim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Radu!

Fjalën e ka kërkuar zonja Bushka, për të na bërë një sqarim lidhur me draftet.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj gjithë të ftuarit që janë të pranishëm këtu, duke iu përgjigjur ftesës sonë, si dhe dhe zonjat parafolëse!

Në thelb ndajmë bashkë gjithë shqetësimin që liria e shprehjes dhe e medias janë thelbësore për zhvillimin e një shoqërie demokratike, ashtu sikundër duhet që shoqëria ta balancojë këtë të drejtë me të drejtat e individëve, për të pasur të garantuara të drejtat e njeriut.

Më duhet t'ju sqaroj disa çështje teknike sa i takon procedurës parlamentare. Nismat për të dy ligjet janë të qeverisë shqiptare dhe janë depozituar në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe do të shqyrtohen nga tre komisione, një prej të cilëve është Komisioni i Ligjeve si komision për dhënie mendimi. Jo më kot është Komisioni i Ligjeve, sepse kemi të bëjmë me të drejtat e njeriut dhe para se ky komision të japë mendimin e tij nuk mundën dot komisionet e tjera të fillojnë shqyrtimin e dy akteve.

Në kuadër të punës në komisione, që është një procedurë parlamentare, unë së bashku me zonjën Hysi, si bashkërelatore e të dyja projektligjeve në Komisionin e Ligjeve, kemi marrë jo vetëm nismat e depozituara nga Këshilli i Ministrave, por edhe opinionet e dhëna nismëtarëve nga zyra e OSBE-së në Vjenë dhe nga strukturat përkatëse të Bashkimit Europian në Bruksel.

Konkretisht shkresat që citoi zonja Bilate janë të dyja pjesë e studimit dhe e punës në komisione që ne kemi bërë, ashtu sikundër edhe dy opinionet ligjore, që OSBE, zyra në Vjenë, ka publikuar edhe në faqen e internetit dhe janë bërë të njohura për publikun. Personalisht, kam kryer takime me ekspertët e OSBE-së, si dhe me përfaqësuesin për Lirinë e Medies, zotin Harlem Dezir në Vjenë dhe në vijim të të dyja opinioneve ligjore falënderoj OSBE-në, e cila na ka vënë në dispozicion një ekspert tjetër, pjesë e skuadrës së ekspertëve të parë, për të komentuar draftet e përmirësuara pas opinioneve të para, edhe të OSBE-së, por edhe të strukturave të Bashkimit Europian. Në tetor të vitit 2019 kemi marrë një mendim të fundit, i cili pa diskutim, si dy draftet e para të OSBE-së dhe dy shkresat e para të Bashkimit Europian, do të bëhet i ditur për publikun dhe do të shpërndahet. Siç edhe jua thashë kemi një procedurë parlamentare dhe në vijim të kësaj procedure çdo material do t'u ofrohet të ftuarve.

Pikërisht drafti që u është shpërndarë të gjitha grupeve të interesit në datën 12 nëntor 2019, të cilat janë thirrur në një maratonë dëgjësash për shqyrtimin e të dyja nismave, si edhe drafti, i cili tashmë është publik, adreson dhe ka përditësuar të gjitha komentet që ngrihen në të gjitha këto opinione të OSBE-së që ju përmenda.

Falënderoj OSBE-në dhe strukturat e Bashkimit Europian për gjithë mbështetjen me ekspertizë që na kanë dhënë, pasi sigurisht këtu bëhet fjalë për një bashkëpunim afatgjatë që do të kemi për çështje të ndryshme të së drejtës dhe nuk mund të themi se draftet do të miratohen së bashku me këto struktura. Ne marrim nga ekspertiza shumë e rëndësishme e këtyre institucioneve dhe përpiqemi t'i përkthejmë në standarde të detyrueshme në të drejtën tonë të brendshme dhe ky proces nuk është se mbaron këtu. Jo më kot ne kemi bërë një kalendar të posaçëm për shqyrtimin e të dyja nismave, sepse drafti që kemi shpërndarë do të diskutohet me grupet e interesit këtu, në këtë sallë, dhe në fund neve na duhet të mbledhim opinionet e të

gjitha grupeve të interesit, duke vijuar bashkëpunimin me OSBE-në e Vjenës, tashmë e kemi marrë mbështetjen për ta pasur këtë bashkëpunim edhe pas dëgjesave, si dhe kemi kërkuar që eksperti i Këshillit të Europës që është i pranishëm këtu të na ndihmojë në formulimet finale pas dëgjesave për të dy ligjet.

Pra, duke qenë se janë dy ligje shumë të rëndësishme, për të cilat është e kotë të diskutojmë nëse ndajmë apo jo të njëjtin mendim, sepse të gjithë ndajmë të njëjtin mendim që duhen bërë sa më mirë, sa më të balancuara me interesat e të gjitha grupeve të shoqërisë dhe duhet të jenë në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare. Për sa kohë ky është mendimi i të gjithëve, mendoj se ky proces duhet të vijojë kështu si është nisur dhe pa diskutim presim ekspertizat e të gjithëve ju që jeni këtu të pranishëm, por edhe të tjerëve nëse do të kenë. Duhet ta dimë që është një proces i gjatë, u bë gati 1 viti që kur ka nisur nisma dhe deri më sot, dhe është konsultuar kaq shumë.

Mendoj se tani ka ardhur momenti, siç e thanë edhe përfaqësueset e Komisionit të Bashkimit European dhe e OSBE-së, disa opinione janë dhënë, draftet janë përmirësuar, por ende ka çështje që duhen përmirësuar, të jemi sa më korrektë, jo vetëm ne, por edhe të gjitha grupet e interesit. Do të ishte i pranueshëm dhe i mirëpritur çdo lloj komenti, por konkretisht për nene dhe çështje të caktuar të ligjit. Tashmë çështjet parimore i kemi shumë të qarta, sepse kemi 1 vit që punojmë dhe kemi rënë dakord për parimet dhe për standardet. Duhet të jemi sa më konkretë, sepse siç e tha edhe zoti Manja, nuk kemi asnjë ngutje, gjë që e kemi të nevojshme për mirëfunksionimin e shoqërisë dhe për të adresuar fenomene të ndryshme për grupe të ndryshme të shoqërisë, të cilat kanë nevojë për zgjidhje të balancuara.

Në mënyrë që të mos e marr më fjalën doja t'ua bëja këtë sqarim. Sigurisht, në kuadër të ligjit për transparencën çdo lloj akti që ne disponojmë do të jetë i gatshëm për t'ua vënë në dispozicion grupeve të interesit dhe publikut në bazë të kërkesave që ata kanë bërë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Bushka!

Edhe një herë shkurtimisht dua t'ju them diçka për procedurën parlamentare. Dy draftet e ardhura nga qeveria në datën 09.07.2019, janë draftet zyrtare, të cilat janë publikuar në faqen e Kuvendit. Kjo është procedura parlamentare. Nga unë, si kryetar i komisionit, në respektim të Rregullores së Kuvendit, janë caktuar dy relatorë për të dyja këto projektligje, zonja Bushka dhe zonja Hysi. Pas diskutimeve ndërmjet dy relatorëve dhe ekspertizës, siç e theksoi edhe zonja Bushka, të OSBE-së në Vjenë, zyra për Lirinë e Medieve, por edhe ekspertizës së Këshillit të Europës kemi ardhur me një draft më të përmirësuar, drafti i datës 12 nëntor 2019, i cili u është shpërndarë të gjithëve. Diskutimi sot dhe seancat dëgjimore që ne do të zhvillojmë

sipas kalendarit që kemi miratuar kanë të bëjmë me përmirësimin e draftit të datës 12.11.2019, që të jemi të gjithë qartë.

Pra, sot ka një draft, që është ai i datës 12 nëntor në bazë të të cilit ne po zhvillojmë këto dëgjesa, por do të mirëpresim çdo lloj ekspertize qoftë nga OSBE-ja, Këshilli i Europës apo delegacioni i Bashkimit Europian, grupet e interesit dhe shoqatat e medieve në Shqipëri.

Për shumë nene të këtyre projektligjeve mund të ndajmë këndvështrime të ndryshme, personalisht bashkohem me kolegët, por edhe me atë çka thanë dy parafolëset e nderuara, në finale i besoj gjykatës. Është gjykata ajo që kemi zgjedhur për të bërë balancën e të drejtave në një shoqëri demokratike dhe të hapur. Që këtu do ta fillojmë diskutimin për këtë draft.

Zonja Hysi, si relatore, do t'ju lutesha një konsideratë...

(Diskutime pa mikrofon)

Keni pyetje?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj gjithë të pranishmit që hapën seancën e konsultimit publik, e cila ka filluar me ju, por nuk mbaron këtu, pasi ne do t'i rikthem si grup pune një për një çdo artikulli.

Do të doja, meqë të pranishëm janë edhe përfaqësues të Këshillit të Europës, ku Shqipëria është palë në disa nga konventat dhe kemi një sërë detyrimesh që duhen përmbushur, të kisha opinione ose mendime konkrete se si mund të adresojmë disa problematika që hasen në mediet *online*, duke filluar me gjuhën e urrejtjes, cenimin e të drejtave të viktimave, fëmijët dhe pornografinë në faqen *online*, çështjet që lidhet me mbrojtjen e jetës private, sekretin në proceset hetimor, por njëkohësisht detyrimet që ne kemi për të zbatuar rekomandimin 15 të ECRI-t i miratuar në vitin 2015 dhe që ka hyrë në fuqi në vitin 2016, lidhur me luftën e gjuhës së urrejtjes në mediet *online* në përgjithësi, konkretisht pika 8 e këtij rekomandimi. Njëkohësisht, në cilësinë e bashkërelatores, kam marrë publikimin më të fundit që ka botuar Këshilli i Europës, 240 vendime të Gjykatës së Strasburgut, ku ka një praktikë shumë të pasur midis nenit 10 të konventës, por edhe nenit 8, si dhe domosdoshmërisë që kemi për të mbrojtur fëmijët në internet, për t'i thënë jo gjuhës së urrejtjes në internet, ku Shqipëria si edhe të gjitha vendet e tjera të Këshillit të Europës nuk bën përjashtim.

Njëkohësisht duhet të vëmë një balancë midis mjeteve civile, administrative, penale dhe vetërregullimit. Këtu kam një pyetje për ekspertin e OSBE-së. Meqenëse ju përmendët kompetencat e mëdha që projektligji i jep ende AMA-s, megjithëse në draftin e fundit, nuk e di sesa ju jeni njohur kompetencat janë limituar më shumë sesa në draftin e sjellë nga qeveria, sipas jush më shumë kompetencë duhet të ketë sistemi gjyqësor në krahasim me mjetet

administrative. Do të doja që në opinionin që do të paraqitet me shkrim të kemi një përgjigje. Në rekomandimin nr. 15 të ECRI-t, por edhe në një sërë konventash të Këshillit të Europës, kur bëhet fjalë për mbrojtjen e fëmijëve dhe për t'i thënë "stop" gjuhës së urrejtjes, thuhet se duhet të merren masa urgjente, në të cilat rruga gjyqësore nuk mund të presë deri sa të mbarojë i gjithë procesi gjyqësor, kështu që është e nevojshme pasja e disa pushteteve të veçanta administrative për t'i adresuar këto shqetësime. Ky rekomandim i kontrollit juridik dhe i mjeteve administrative, si dhe i vetërregullimit që duhet të bëjnë mediet dhe institucionet, pasi ne ende nuk kemi një institucion, i cili mund të adresojë shqetësimet e medias *online*, në çfarë raporti duhet të jetë? Sa e respekton drafti këtë standard dhe cili do të ishte riformulimi konkret?

E them këtë, pasi mund të jem një ndër deputetet, zoti Sala mund t'ju konfirmojë, që bëj shpesh ankesa te bordi i ankesave për gjuhën e urrejtjes, ksenofobinë, homofobinë, racizmin. E them këtë, sepse jam edhe anëtare e Komisionit European Kundër Racizmit dhe Intolerancës në Këshillin e Europës dhe mua nuk më lejohet që në portale në komentet të ketë gjuhë urrejtjeje dhe fobike, që kalon në konsumim të veprës penale të neneve 253, 255 dhe 256 të Kodit Penal. E thashë si paradhënie edhe për ekspertin e OSBE-së, por edhe në fjalën e që do të marrë ekspertja e Këshillit të Europës.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Hysi!

Nuk besoj se do të ndërhyjmë ne si komision më, sepse ju kemi thirrur t'ju dëgjojmë ju sot, por për sa kërkoi kolegja Hysi, si relatorë mund t'i sillni përgjigjet me shkrim, por unë do t'ia kaloj fjalën zonjës që ka kohë që e ka kërkuar atë.

Fjoralba Shkodra - Faleminderit! Unë jam shefe e zyrës së Koordinatorit të Përhershëm të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri. Meqenëse përfaqësoj institucionin, do të më lejoni që disa komente të shkurta që do të mbajmë për draftligjet t'i paraqes në anglisht me ndihmën e përkthyeses, nëse më lejoni.

Unë do të bëj me dije shumë shkurtimisht disa prej komenteve kryesore që ne kemi identifikuar në lidhje me dy projektligjet që i janë dërguar Komisionit të Ligjeve.

Thjesht më lejoni t'ju them se mendimi, i cili është ofruar nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut është dhënë në një mënyrë pozitive dhe në kuadrin e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Atëherë, siç u theksua edhe nga koleget e mia, të cilat folën më përpara, duhet që të vihet re dhe të shënohet me pozitivitet fakti që qeveria po bën përpjekje për të luftuar shpërndarjen e materialit që çon në nxitje të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Kjo është në

përputhje me detyrimet që i rrjedhin vendit si rezultat i Konventës për të Drejtat dhe Liritë Civile dhe Politike, më specifikisht nenit 20 të saj.

Po ashtu në këtë aspekt më lejoni të them që specifikisht neni 33/1, pika 4, përcakton një detyrim të qartë për ofruesit e përmbajtjes mediatike për t'u kufizuar nga nxitja e shpërndarjes së urrejtjes dhe diskriminimit. Gjithashtu, në këtë nen jepet një listë e gjatë e mbrojtjes nga diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes. Në të njëjtën kohë më lejoni t'ju them se qeveria duhet të miratojë një qasje gjithëpërfshirëse për të trajtuar shkaqet dhe shtytësit kryesorë të gjuhës së urrejtjes përmes një game të gjerë veprimesh, të cilat kanë si qëllim kryesor të promovojnë të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, së pari, mbi të gjitha, Shqipëria duhet të ketë një strategji të promovimit të arsimit si një instrument parandalues që çon në rritjen e ndërgjegjësimit dhe përgjegjshmëri të përbashkët për të realizuar dhe trajtuar, siç duhet shkaqet dhe rrënjët kryesore të urrejtjes.

Po ashtu, në lidhje me atë çfarë u tha më sipër dhe në përputhje me strategjinë e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër gjuhës së urrejtjes, Kombet e Bashkuara mund të luajnë në rol shumë të rëndësishëm për të vazhduar për të mbështetur qeverinë e Shqipërisë në bashkëpunim me aktorë të tjerë të shoqërisë civile dhe me partnerë të tjerë për të trajtuar gjuhën e urrejtjes ndërkohë që respektohet dhe sigurohet liria e opinionit dhe e shprehjes.

Pavarësisht mbështetjes dhe vlerësimit të aspekteve pozitive dhe përmirësimeve që u janë bërë dy projektligjeve trajtimi i gjuhës së urrejtjes nuk duhet të çojë asnjëherë në shtypjen e lirisë së shprehjes. Këtu i referohemi nenit 53, pika 1 që ka të bëjë me lirinë e reputacionit dhe dinjitetit, që shihet i lidhur me nenin 133 që parashikon zbatimin e gjobave shumë të larta administrative në raste të shkeljeve të dispozitave të përmendura më sipër.

Kjo masë e ashtuquajtur masë kundër shpifjes, e cila synon të mbrojë reputacionin e individëve nga dëmtimi, mund të çojë, gjithashtu, edhe në efekte negative të të drejtave të njeriut, në heshtjen e gazetarëve investigativë ose të mbrojtësve të tjerë të të drejtave të njeriut dhe për këtë arsye shprehim kritikën tona lidhur me këtë pikë. Këto çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e reputacionit dhe dinjitetit duhet të mbeten çështje nën kompetencën e gjykatave.

Komiteti për të Drejtat e Njeriut ka deklaruar se duhet t'i kushtohet kujdes nga shtet palë për të shmangur masat e tepruara ndëshkuese dhe gjokat e tejskajshme. Për këtë arsye së bashku me detyrimin e përgjithshëm të shteteve për të promovuar një mjedis mundësues për lirinë e shprehjes duhet t'i kushtohet më shumë kujdes sa i takon rregullimit të lajmeve të rreme dhe dezinformimit. Në vitin 2017 në një deklaratë të përbashkët për lirinë e shprehjes dhe në një deklaratë kundër lajmeve të rreme për dezinformimin dhe propagandën është theksuar se

shtetet palë duhet t'i përgjigjen këtyre fenomeneve, duke forcuar dhe promovuar median e ligjshme dhe të denjë më shumë se duke marrë masa për ndalimin e shprehjes. Po ashtu në vijim të komenteve që u dhanë nga dy bashkëreporterët për dy projektligjet dhe duke theksuar edhe një herë faktin që qeveria ka marrë masat e saj pozitive dhe ka marrë hapa të njëpasnjëshëm, duke filluar që nga dhjetori i vitit 2018 dhe duke vijuar më tej në vitin 2019, ne i vlerësojmë të gjitha përpjekjet dhe të gjithë kontributin e bërë për përmirësimin e drafteve që kemi përpara. Ndërkohë, vijojmë të theksojmë se është e rëndësishme që të vazhdojë të merret kontributi i këshilltarëve ndërkombëtarë dhe i organizatave rajonale që kanë rol në këtë fushë.

Nga ana tjetër, kjo, siç e kemi parë edhe nga ligji, çon edhe në kërkesën për regjistrim të domosdoshëm. Për këtë arsye do të duhet që të ketë më shumë konsultime në projektligj në mënyrë që dispozita të tilla të mos cenojnë lirinë e shprehjes, pavarësinë e medias dhe të mos ketë kompetenca të tilla, të cilat mund të çojnë në bllokimin e përmbajtjes *online*, pasi ato do të kenë në ndikime negative.

Bllokimi i propozuar i faqeve të internetit ngre shqetësime, të cilat mund të çojnë në mungesën e garancive për proces të rregullt dhe do të doja të thosha që për detaje të tjera, për komente më shteruese lidhur me projektligjet, ne do të depozitojmë në sekretariatit e Komisionit të Ligjeve dokumentin tonë të shtjelluar në detaje.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Do të doja të ripërsëritja që do të ishte një kontribut shumë me vlerë nga secili prej jush që të fokusoheni në nene të caktuara të projektligjet, sepse në parim paketa është prezantuar. Në parim edhe do të votohen dy projektligjet, sepse janë dy nisma që kanë ardhur nga qeveria dhe janë në procedurë parlamentare, ndaj kontributi juaj do të ishte me vlerë që nëse keni komente për nene të caktuara të projektligjit, siç edhe unë kam mbajtur shënim disa çështje konkrete, që kanë të bëjnë me gjobat ose bllokimin e faqeve të internetit, rolin e gjykatës e kështu me radhë që i kam mbajtur me shumë vëmendje shënim dhe që do të kujdesemi maksimalisht që të jenë në harmoni të plotë edhe me standardet më të mira të lirisë së medievet sot, ju ftoj edhe ju të bëni të njëjtën gjë, jo vetëm sot, por edhe në ditët në vazhdim. Nëpërmjet postës elektronike jeni të lutur t'i adresoni në sekretarinë e Komisionit të Ligjeve.

Fjalën e ka kërkuar përfaqësuesi i Këshilli të Europës.

Zoti Gjoni, nëse nuk e keni kuptuar që jemi në dëgjuesë publike, kemi ftuar të tjerët për të dëgjuar dhe jo ata ne.

Ne rezervojmë të drejtën që, pasi të shprehen për komentet përfaqësuesit që kemi thirrur, mund të marrim fjalën dhe të bëjmë ndërhyrjet tona.

Ralf Gjoni - Unë erdha në këtë mbledhje tërësisht i përgatitur të mos flisja fare derisa të dëgjonim të gjithë të ftuarit e tjerë, që unë personalisht si deputet i opozitës i konsideroj shumë të rëndësishme, por dëgjova më tepër fjalë të artikuluar nga deputetë të Partisë Socialiste sesa nga të ftuarit. Kështu që, pavarësisht relatorëve, unë nuk kërkoj të flas tani, por do të flas më vonë kur të më jepet fjala.

Mendoj se edhe ju, si përfaqësues të Partisë Socialiste, duhet të jeni më kokulur dhe le t'i dëgjojmë të gjitha shqetësimet e shprehura nga organizatat ndërkombëtare dhe kombëtare prezente në këtë takim dhe pastaj të flasim.

Si gjithmonë, Partia Socialiste është shpërfillëse ndaj opozitës. Unë kam disa fjalë për të thënë në emër të opozitës këtu në komision dhe dëshiroj t'i ndaj ato edhe me të ftuarit, por do të pres të mbarojnë diskutimet me të ftuarit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Nuk dua të komentoj rreth punës që bën ky komision, sepse sa kokulur jemi ne dhe sa kokëngritur jeni ju, nuk besoj se i vlen mbledhjes së sotme. Ne jemi këtu për të bërë detyrën, në radhë të parë, pse jo, edhe për të dëgjuar deri në fund të ftuarit, pasi produkti që na kërkohet të votojmë në Kuvend, do t'iu shërbejë interesave më të mira të qytetarëve shqiptarë.

Do të kemi durimin të dëgjojmë secilin prej jush, jo vetëm të ulurit në tryezë, por edhe pjesën tjetër të sallës, nëse do të kenë komente për projektligjin.

Fjala është për përfaqësuesen e Këshillit të Europës.

Deirdre Kevin – Përshëndetje!

Faleminderit Komisionit të Ligjeve që më ftuat në këtë dëgjese publike!

Faleminderit edhe Këshillit të Europës!

Unë jam eksperte rregullatore e pavarur e medias dhe sot jam këtu në cilësinë e ekspertes së Këshillit Europës.

Kam përgatitur një raport të detajuar me shumë komente për nene dhe pika specifika të dy projektligjeve, të cilin do ta depozitoj në sekretari.

Në hapje të diskutimit tim, më duhet të them se i gjithë diskutimi duhet të fillojë nga përmbajtja. Kështu që mendoj se pyetja e parë që duhet të bëjmë është: çfarë nuk kuptohet nga përmbajtja ose cili është përkufizimi i saj në kuadrin e këtyre dy projektligjeve?

Kur flasim për përmbajtjen, në fakt, flasim për lloje të ndryshme përmbajtjesh, në aspektin kriminal ose penal, domethënë, në qoftë se flasim për pornografinë e fëmijëve, atëherë kemi të bëjmë me përmbajtje që çon një vepër penale; flasim për përmbajtje në aspektin ligjor, për shembull, nxitja e gjuhës së urrejtjes ose e diskriminimit; flasim për përmbajtje në aspektin e dëmshëm, ndoshta për kategori të caktuara njerëzish një përmbajtje mund të mos jetë e

dëmshme, por mund të jetë e dëmshme për fëmijët; flasim për përmbajtje në aspektin audioviziv, siç e dini ka rregullime tashmë në nivelin e Bashkimit Europian që flasim për platforma, *vidiosharing online* një fushë, e cila ka filluar të rregullohet; po ashtu flasim për përmbajtjen kur dy palë kanë mosmarrëveshje me njëri-tjetrin, domethënë, kur njëra palë i adresohet një pale dhe pala marrëse pretendon se bëhet fjalë për argumente false për shpifje.

Pra, do të doja ta nisnim diskutimin duke menduar që kur flasim për përmbajtje në kuadrin e të dy projektligjeve, nocioni i përmbajtjes është shumë i gjerë. Flasim për lloje të ndryshme përmbajtjesh, si rezultat edhe zgjidhja që duhet të jetë në përmbajtje të tilla, duhet të jetë të ndryshme.

Megjithëse nuk do t'i kaloj të gjitha gjërat që i kam përgatitur me shkrim, do të mundohem të përqendrohem në disa prej pikave kryesore.

Në qoftë se do të marr parasysh draftin e mëparshëm që më është vënë në dispozicion në qershor dhe draftin e fundit të muajit nëntor, qëllimi ose objektivi i të dy drafteve është i njëjtë. Ndërkohë, siç u tha gjatë ditës së sotme këtu, drafti i fundit ka më shumë përmirësime dhe natyrën e përmirësimeve e diskutoi edhe ekspertja e OSBE-së.

Ndërkohë, mendoj se për momentin nuk është qasja më e mirë që t'u futemi neneve njëri pas tjetrit, por do të ishte mirë të flisnim mbi bazën e problemeve dhe shqetësimeve rreth neneve që ia vlen të diskutohen.

Kategoria e parë për të cilën do të doja të flisja, është kategoria e ndryshimeve, të cilat i fusin nën të njëjtin nen ose trajtim ligjor botimet *online* dhe regjimin rregullator statutor.

Ajo që vihet re në versionin e fundit të projektligjit është se media e shkruar duket sikur vihet në të njëjtin regjim si përmbajtja audiovizive, domethënë, si media audiovizive ose si transmetuesit, që duhet të kenë një licencë për të bërë transmetimet e tyre.

Siç e dini, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut ka një nen të posaçëm për të garantuar lirinë e shprehjes, ndërkohë, edhe Gjykata e Strasburgut ka jurisprudencë të zhvilluar sa i takon lirisë së shprehjes, ndërkohë që kufizimet e lirisë së shprehjes, në fakt, duhet të jenë proporcionale.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut thuhet: "Kufizimet për lirinë e shprehjes të parashikuara në nenin 10, paragrafi 2, duhet të jenë të kufizuara në mënyrë strikte.

Ndërhyrja nga shtetet në ushtrimin e kësaj lirie është e mundur, me kusht që kjo ndërhyrje të jetë e nevojshme në një shoqëri demokratike.

Parashikohet që këto ndërhyrje duhet të përkrijnë me një nevojë të madhe sociale, duhet të jenë proporcionale dhe duhet t'i shërbejnë legjitimitetit të qëllimit që ndiqet.

Është e arsyeshme që vendimet gjyqësore që vendosen, në qoftë se ndërhyrjet e tjera janë racionale dhe të bazuara, duhet të përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm për të justifikuar vënien e kufizimeve të tilla”.

Siç e cekta më sipër, problemi qëndron te fakti se media *online* shihet sikur rregullohet në të gjithë grupin e medias së shkruar, ndërkohë që ndryshimet në vetvete sjellin lloje të ndryshme të medias *online*, që shkojnë përtej fushës së ligjit për mediat audiovizive dhe sistemit rregullator mediatik.

Ky propozim, siç e dini, është kritikuar edhe në versionet e para apo në analizat e rishikimit të parë të dërguar nga Këshilli i Europës në vitin 2018 dhe ky shihet si një standard, i cili cenon medien e shkruar, shtypin dhe mund të ketë ndikim po ashtu edhe në degë të tjera të medias.

Zakonisht standardi ka qenë i tillë që rregullimi iu lihet mediave në dorë përmes institucioneve të ndryshme që mund të jenë, për shembull, këshilla apo komisione të shtypit dhe ndërkohë, me çfarë shohim, ky është një element, i cili ka mbetur i pandryshuar ende në versionin që kemi para.

Këshilli i Europës ka botuar një gamë të gjerë rekomandimesh dhe rezolutash, që kanë të bëjnë me vetërregullimit në medie. Në fakt, kam dhënë një listë të gjatë të vetërregullimit të botuara nga Këshilli i Europës, të cilat nuk do t’i cek njëra pas tjetrës. Nëse jeni të interesuar, lexojeni të plotë dokumentin, ndërkohë do të përqendrohem vetëm në disa prej tyre.

Siç e dimë të gjithë dhe siç është thënë qartë edhe në analizën e Këshillit të Europës, ndikimi që ka interneti në jetën tonë dhe për mediat në veçanti, është rritur në mënyrë të jashtëzakonshme. Ai luan një rol të rëndësishëm sa i takon informacionit, lajmeve, zbavitjeve apo edhe edukimit. Ndërkohë, kemi faqe interneti aktive, të cilat përfshijnë jo vetëm versione *online* të medias tradicionale, po në të njëjtën kohë përfshin edhe një gamë të gjerë zërash.

Një gjë e cila reflektohet dhe nënvizohet në dokumentet e Këshillit të Europës është mbështetja për gjetjen e metodave vetërregulluese deri në masën më të madhe të mundshme. Pra, rekomandimi është të gjenden instrumente vetërregullatore në këtë fushë.

Sa për të sjellë një prej shembujve të instrumenteve të shumtë që ekzistojnë në KE sa i takon rregullimit të medias, dua t’i referohem Asamblesë Parlamentare të KE-së, që në rezolutën e saj ka të bëjë me etikën në media në një mjedis ndryshues mediatik. Pra, është një deklaratë e cila parashikon si më poshtë:

“Asambleja e njeh vetërregullimin nga media si një mënyrë për uljen e ndikimit të shtetit dhe të sektorëve të tjerë të shoqërisë për përmbajtjen e medias. Për më tepër mekanizmat vetërregullatorë mund të lehtësojnë marrëveshjet ose gjetjen e zgjidhjeve jashtë gjykate për

mosmarrëveshje që mund të ekzistojnë për përmbajtjen e medias. Megjithatë Asambleja u kujton shteteve anëtare që kufizimet nga autoritetet publike të lirisë së shprehjes dhe të informacionit përmes medias, duhet të parashikohen me ligj, duhet të ndjekin një objektiv legjitim dhe duhet të jenë të nevojshme në një shoqëri demokratike. Pra, vetërregullimi në media duhet të jetë vullnetar dhe i natyrës etike më tepër sesa i detyrueshëm në aspektin ligjor”.

Siç e dimë ekzistojnë shqetësime të gjera, jo vetëm këtu, por edhe në shumë vende të tjera të botës, lidhur me fenomenin që ndryshe quhet fenomeni i dezinformimit, ose përhapja e dezinformimit përmes internetit, duke përdorur kryesisht rrjete sociale interneti ose rrjete të ndryshme mediatike. Ka një numër të shtuar iniciativash që po hartohen në mënyrë që kjo çështje të trajtohet, e cila është nxjerrë në pah dhe është shtjelluar në detaje edhe nga një botim i fundit goxha i mirë i OSBE-së, që mundohet të përcaktojë standardet kryesore për kontrollin e fakteve, si dhe të përcaktojë mënyrën se si të kufizohet për aq sa është e mundur dezinformimi. Po ashtu ekziston edhe një Kod Etike në nivel të BE-së, i cili i bën operatorët e ndryshëm mediatikë të respektojnë me detyrim Kodin Etik dhe të kufizojë sa të jetë e mundur pjesën e dezinformimit.

Mënyra se si e lexoj ligjin, të paktën formulimin e tij, më duket se nuk i jepet një rëndësi shumë e madhe dezinformimit, por elementit të shpifjes.

Kam shumë informacione të tjera të detajuara në të gjithë raportin që kam përgatitur për këtë tryezë, por që të mos ju marrë më tepër kohë mendoj të kaloj te pjesa e përfundimeve, nëse jeni dakord.

Ulis Manja – Jemi dakord dhe na i lini me shkrim.

Deirdre Kevin – Përpara se të kaloj te pjesa e përfundimeve dua të cek pak edhe pjesën e të drejtës së përgjigjes, që është një element i rëndësishëm në projektligj, por është edhe një element, i cili u ngrit nga ekspertët e tjerë ndërkombëtarë. Pra pak a shumë procesi, siç parashikohet në projektligjin në fjalë, është që AMA të bëjë vetërregullimin, ose të jetë institucioni përgjegjës për trajtimin e kërkesave. Lidhur me këtë element Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka zhvilluar një jurisprudencë të konsiderueshme, e cila përcakton kufijtë e lirisë së shprehjes dhe kufijtë e kufizimit të kësaj lirie kur balancohen kundrejt të drejtave individuale, në veçanti lidhur me aspektin e reputacionit. Pra jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Strasburgut është e jashtëzakonshme, e konsiderueshme dhe demonstroi një proces shumë kompleks që përfshin edhe përcaktimin nëse ka shkelje apo jo të nenit 10 të konventës. Jurisprudenca e gjykatës ka si qëllim kryesor të informojë dhe të japë udhëzime për gjyqësorët kombëtarë, pra për gjykatat kombëtare, sa i takon vendimmarrjes për çështjet për shpifjet.

Arsyet pse bëhet shumë e vështirë për ne të kuptojmë se si agjencia rregullatore mund të jetë e aftë për t'iu përgjigjur ankesave brenda 72 orëve ka të bëjë me faktin se nivele të ndryshme personalitetesh dhe personat që u përkasin grupeve të ndryshme kanë nivele të ndryshme tolerance, sa i takon shpifjes apo prekjes së privatësisë së tyre. Për shembull, politikanët, apo figurat publike kanë një prag më të lartë ekspozimi, ndonjëherë është e vështirë të bëhet dallimi ndërmjet deklaratave të fakteve dhe shprehjes së opinionëve, ose mendimeve vetjake të personave që më pas çojnë në prekjen e privatësisë të personave që drejtohen në deklarata të tilla. Domethënë çështja në vetvete është kaq komplekse sa është e vështirë për ne të kuptojmë se si Enti Rregullator mund të jetë në gjendje që brenda 72 orëve t'iu përgjigjet ankesave të palëve. Pra nëse ligji në vetvete nuk përfshin versionin *online* të shtypit, i bie që të vijmë në situatën ku kemi trajtim diskriminues të ndryshëm të një lloji medie në raport me një medie tjetër. Kështu që kjo mund të jetë një problem tjetër që ngrihet në kuadrin e projektligjeve në fjalë.

Ndërkohë e kuptoj se sa të vështirë e keni ju, sepse është sjellë një herë versioni fillestar i projektligjit, më pas palët e interesit u shprehën sipas fushave të tyre të interesit dhe të ekspertizës dhe juve ju është dashur të bënit ndryshimet përkatëse. Ky është një proces që është përsëritur herë pas here, kështu që e kuptoj se sa e vështirë duhet të jetë në këndvështrimin e hartimit, apo të përmirësimit të drafteve të tjera të projektligjit. Personalisht do t'ju rekomandoja që mbase të bënit një hap mbrapa dhe ta mendoni mënyrën e zgjidhjes që keni dhënë për këtë pikë, pra për pjesën e publikimeve dhe botimeve, të cilat do t'iu nënshtrohen të njëjtave elemente kontrolli, ashtu sikurse llojeve të tjera të transmetimeve audiovizive online. Të paktën me sa unë e njoh praktikën e KE-se dhe të vendeve të tjera, nuk di të ekzistojë një praktikë e tillë që të jepet zgjidhje për botimet nën ombrellën e përgjithshme të trajtimit të materialeve audiovizive.

Po ashtu rekomandohet të krijohet një lloj mekanizmi bashkërregullator, që i përfshin të gjithë aktorët e mundshëm, në mënyrë që të sigurohet parandalimi i shpërndarjes së përmbajtjes së dëmshme dhe të pavërtetë, ose e thënë ndryshe, dezinformim, gjë që do të çonte në dëmtimin e debatit demokratik, pra të përdoret këshilli i shtypit ose një organ tjetër, në mënyrë që të shihet mundësia e përdorimit të mekanizmave bashkërregullatorë.

Po ashtu një tjetër gjë që më ka bërë përshtypje, por që ndoshta nuk është fare e qëllimshme, është thjesht produkt i punës së bërë, që unë e përmend pak më sipër, në sensin që, ju keni bërë një version, pastaj i keni marrë dhe i keni reflektuar komentet, domethënë mund të jetë thjesht pjesë automatike e punës që keni bërë, jo e qëllimshme. Megjithatë, e kam për pjesën e urgjencës, që duket sikur e karakterizon ligjin, lidhur me trajtimin e shpifjeve, nuk

duket sikur i njëjti nivel urgjence aplikohet edhe në rastin e ndalimit të nxitjes së gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Gjërat, kështu siç janë, nuk janë proporcionale, prandaj them që ndoshta është mirë që të merret një hap dhe të shikohet profesionaliteti i trajtimit të fenomeneve të tilla. Prandaj është e rëndësishme të mendohet në kuadrin dhe në suazën e përmbajtjeve të ndryshme, që unë ceka në fillim, dhe të regjimeve e zgjidhjeve të ndryshme, që duhet të përdoren për të zgjidhur llojet e ndryshme të problemeve në përmbajtje të ndryshme.

Një tjetër element që unë dua të sjell në vëmendje dhe është cekur më parë edhe nga OSBE-ja është pjesa e krijimit të një regjistri, ku, sipas mendimit tonë, regjistri i medias duhet të përfshijë edhe elementin e pronësisë, sepse pronësia e mediave çon në më tepër transparencë, në më shumë media të lirë dhe pluraliste dhe të ndihmon për të pasur një panoramë më të mirë të situatës.

Në të njëjtën kohë unë dua t'ju inkurajoj që në momentin kur të keni finalizuar punën për të dyja projektligjet, ju të kërkonit një mendim zyrtar nga Këshilli i Europës, sepse Këshilli i Europës ka ekspertizën e nevojshme për të dhënë ekspertizën e tij dhe, jo vetëm kaq, por në rezolutën 2179, paragrafi 7, parashikohet që shtetet anëtare të Këshillit të Europës kërkojnë për analiza të pavarura të ligjeve dhe praktikave të tyre, të cilat kanë ose mund të kenë një efekt ndikues në lirinë e medias, ose mund të kenë ndikim në sigurinë kombëtare, në çështjet e terrorizmit, të shpifjes, apo mund të prekin punën e komisioneve të tjera të të drejtave të njeriut, Avokatit të Popullit, ose institucioneve të tjera, të cilat japin kontributin e tyre për lirinë e medias.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Kevin!

Në fakt, ne e kemi menduar që t'i drejtohem Këshillit të Europës për ekspertizë. Zonja Bushka, si relatore, është përfaqësuesja jonë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës, ku e kemi diskutuar edhe këtë çështje dhe do t'i adresohemi shumë shpejt. Edhe gjatë këtyre ditëve, që vazhdojnë dëgjesat, do të ketë një korrespondencë zyrtare për të kërkuar edhe ekspertizën e Këshillit të Europës.

Shumë faleminderit!

Për Komisionin e Ligjeve, por edhe për opinionin publik, jeni e lutur që t'i depozitoni me shkrim ato që bëtë të ditura!

Kush e do fjalën? Fjalën e ka përfaqësuesja e Avokatit të Popullit!

Erjona Canaj – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë, relatore, zonja Bushka dhe Hysi,

Ju falënderoj në emër të institucionit për ftesën që na keni bërë dhe që të shprehemi lidhur me projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”!

Në tryezat që janë zhvilluar gjatë këtij viti, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në mënyrë aktive për të dhënë kontributin e tij. Edhe ne kemi përgatitur një relacion, por për shkak të kohës dhe rrethanave...

Kam disa gjëra, që mendoj se janë interesante për t’i ndarë në këtë tryezë.

Së pari, është e vërtetë që projektligji synon të disiplinojë dhe të normojë organizimin dhe funksionimin e shërbimit të medias, me fokus të veçantë në shërbimin e publikimeve elektronike dhe patjetër i kushton një rëndësi të veçantë përgjegjësisë së ofruesëve të shërbimeve, me qëllim vënien para përgjegjësisë administrative, ndërkohë, ai ka përcaktuar edhe Këshillin e Ankesave dhe bordin si organe vendimmarrëse të AMA-s. Megjithatë, çështja që diskutojmë është vërtet problematike, sepse, në fund të fundit, edhe Gjykatës së Strasburgut, të cilës i drejtohem dhe, pa dyshim kemi shumë vendime të saj lidhur me lirinë e shprehjes, kur të gjitha kufizimet që vijnë janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, herë pas here ndryshon qëndrimin e saj në varësi të rrethanave të çështjes. Kështu që kjo gjithmonë qëndron si problematikë dhe duhet zgjidhur rast pas rasti.

Një nga elementet kryesore të vështirësisë që kemi në këtë rast është funksionimi i Këshillit të Ankesave, ku përcaktohen rregullat specifike për trajtimin e ankesave të parashtruara pranë Këshillit dhe Bordit, së bashku me përcaktimin e kriterëve të qarta për zbatueshmërinë e sanksioneve të parashikuara nga ky ligj, me qëllim respektimin e parimit të proporcionalitetit. Unë dua të ritheksoj përsëri parimin e proporcionalitetit, i cili duhet të qëndrojë si një parim shumë i rëndësishëm dhe të vendoset në dispozitat fillestare të ligjit, pasi është një nga parimet që duhet respektuar, sidomos në konstatimin e shkeljes, ose jo, dhënien e gjobave dhe masave të marra nga ana e Këshillit të Ankesave dhe bordit të AMA-s. Lidhur me këtë, mendoj se duhet bërë pak kujdes. Është e vërtetë që Këshilli do të veprojë si autoritet kuazi gjyqësor dhe askush nuk e konteston më këtë pjesë, sepse marrja e masave administrative, në rastet kur ka shkelje, ku përfshihen të miturit, siguria kombëtare, terrorizmi e të tjerë, është e nevojshme që të ketë një afat kohor. Megjithatë, mendoj se kur bëhet fjalë për nevoja ekstreme dhe situata efektivisht problematike, në krahasim me ato që janë më të qeta, konstatime ose shkelje, që nuk janë aq emergjente sa rastet e parashikuara në këtë drejtim, duhet të ketë një regjistrim specifik. Ndërkohë, unë dua të përgëzoj bashkërelatoret për punën e madhe që është bërë në drejtim të rishikimit të draftit.

Në përfundim të fjalës sime dua që të rishihen përsëri, jemi dakord me çështjen e regjistrimit dhe të identifikimit të ofruesit të shërbimeve, mekanizmat që do të përcaktohen për trajtimin e ankesave.

Ju falënderoj!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Canaj!

Kush ka diçka për të shtuar? Po, zoti Sala.

Gentian Sala- Lidhur me deklaratat e përfaqësuesve të Bashkimit Europian dhe të OSBE-së, kam disa paqartësi në komentet e bëra, sepse përfaqësuesja e BE-së thotë që versioni duhet parë dhe duhet rregulluar, ndërkohë më pas thotë që i bashkohem shqetësimit të OSBE-së për AMA-n, e cila i thotë AMA-s që duhet të jetë bord gjyqësor. Pra, e hedh poshtë diskutimin në thelb, sepse AMA shtylla e ndryshimeve. Pastaj diku thotë që propozon vetëregullimin, e cila hedhë poshtë propozimet, sepse është diçka komplet e ndryshme. Edhe përfaqësuesja e OSBE-së, Irina, thotë që drafti ka përmirësime, pastaj thotë që AMA të mos jetë e përfshirë. Deklarata e OSBE-së dhe BE-së janë deklarata që çdo lloj institucioni që mund t'i lexojë, edhe diametrikisht të kundërta, mund ta gjej veten.

Deklaratat e BE-së këtu me deklaratat e ambasadorit të BE-së në krah të gazetarëve janë të ndryshme. Në krah të gazetarëve është thënë shkoqur që duhet vetrregullim, ndërsa këtu thuhet që duhet përmirësim.

Te deklarata e OSBE-së ka diçka më të thellë, sepse ajo i thotë AMA-s që duhet të jetë trupë gjyqësore, ndërkohë që ndryshim të objektit të veprimtarisë së AMA-s nuk ka, por ka zgjerim të... Është OSBE-ja, e cila ka qenë mbikëqyrëse e ligjit të parë, ku i thotë AMA-s se pas kësaj çfarë thuhet, ti duhet të jesh gjyqësor. Pra, më duken deklarata pak të paqarta.

Ajo që shoh unë është se OSBE-ja nuk i jep përgjigje të qartë as draftit të qeverisë dhe as gazetarëve, por targeton institucionin e pavarur dhe thotë që ti duhet të jesh kështu, ndërkohë që para 5 vjetëve ka miratuar ligjin. Vendimi i AMA-s është i qartë, e kemi bërë me bord, por këto ishin thjesht konstatime.

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Sala!

Në fakt, ndërhyrjen tuaj e shoh në sensin që ju me të drejtë e kërkuat fjalën, sepse bëhet fjalë për një ndryshim në ligjin nr. 97 të vitit 2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ku ju jeni kryetar i AMA-s dhe ky është ligji juaj organik, por deri këtu. Natyrisht që mund të kemi dhe do të kemi këndvështrime të ndryshme për projektligjin, prandaj jemi në këto dëgjesa që po zhvillon Komisioni i Ligjeve, sepse shumë gjëra, në tekstin e projektligjit të datës 12 nëntor të vitit 2019, mbi të cilin po zhvillohen edhe diskutime, kanë nevojë të përmirësohen dhe të qartësohen, në mënyrë që kur ligji të miratohet në Kuvend dhe të zbatohet

në praktikë, të mos ketë paqartësi në lidhje me ato koncepte dhe ato problematika që ne duam të rregullojmë nëpërmjet këtyre ndryshimeve. Nëse keni komente me shkrim, si Autoritet i Mediave Audiovizive, jeni të ftuar që t'i sillni pranë komisionit dhe të jenë në dispozicion të relatorëve. Do të jeni patjetër pjesë e punës, sepse, në fund të fundit, ne po ndërhyjmë në ligjin e mediave audiovizive, në ligjin tuaj, dhe nuk do të kishte sens nëse ju nuk do të ishit pjesë e grupit të punës dhe e diskutimeve për këtë projektligj.

A ka diçka për të shtuar?

Deirdre Kevin – Nuk dua të marr kohë nga koha juaj, por dua të sqaroj diçka, sepse ndoshta nuk isha e qartë në atë që thashë më parë dhe mund të ketë pasur ndonjë keqkuptim nga ana ime. Megjithatë, ajo që thamë dhe nënvizuam ne, të katërt, ishte që do të ishte mirë të kishte një qasje, e cila të ishte më pak e rëndë. Pra, me fjalë të tjera, të kishim një qasje vetërregullatore. Prandaj, dua t'ju sqaroj që ne ishim të katërt në të njëjtin drejtim dhe të gjithë folëm për një qasje vetërregullatore.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Edhe ne, në fakt, qoftë delegacioni i BE-së, zyra e Këshillit të Europës, prezenca e OSBE-së në Shqipëri, por edhe organizata të tjera ndërkombëtare, e kam fjalën për UNDP-në, USAD-in apo për të gjithë ekspertët, ju kemi ftuar dhe u jemi drejtuar për ekspertizë. Sigurisht edhe ne mirëpresim ekspertizën tuaj, por të dyja këto drafte janë procedurë parlamentare dhe i mirëpresim të gjitha komentet tuaja, duke përfshirë edhe ato të AMA-s.

Dua t'ia jap fjalën kolegut tim, zotit Gjoni.

Ju lutem, bëni një koment në lidhje me temën e diskutimit!

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti Manja!

Në fakt, me të gjithë respektin personal për kryetarin e Komisionit të Ligjeve, apo për dy relatorët, zonjën Hysi dhe zonjën Bushka, mua si përfaqësues i vetëm i mbetur sot në këtë tryezë nga opozita në parlament, por jo më pak vokali nga opozita, më duhet të shpreh një dy opinionë lidhur me një terren që them se, për shkak të eksperiencës sime të mëparshme profesionale, e njoh jashtëzakonisht mirë. Ndoshta edhe një dy opinionë për përfaqësuesit e nderuar ndërkombëtarë, të cilët i ftoj ta marrin shënim këtë koment në emër të opozitës dhe grupimeve parlamentare të opozitës së parlamentit. Normalisht, propozimi për legjislacion, draftim ose ndërhyrje në një legjislacion kaq të rëndësishëm në vend, normale edhe europiane, vjen nga nisma të deputetëve, të parlamenteve, ndoshta edhe me shtysën e organizatave të shoqërisë civile. Me të gjithë respektin për tre kolegët e nderuar të Partisë Socialiste, me të cilët bashkëpunoj shumë mirë, në Shqipëri terreni është krejt ndryshe, nismat gjithnjë vijnë nga Këshilli i Ministrave. Në një terren shqiptar, që unë e cilësoj si neotoman në mentalitetin politik

dhe social. Kur themi Këshilli i Ministrave, kemi të bëjmë me një individ që është Kryeministri i Shqipërisë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A ka mundësi të shpreh mendimet e mia?

Ulsi Manja – Zoti Gjoni, shprehuni lirshëm!

Ralf Gjoni – Do të shprehem lirshëm, sepse ky është problemi

Ulsi Manja – Do të gjej reflektim edhe në tekstin e projektligjit liria e shprehjes sate.

Ralf Gjoni – Kjo është tipikisht çfarë ndodh në parlament.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ju kërkoja asnjë opinion, do të flas deri në fund dhe do të më dëgjoni deri në fund me respekt, siç ju kam respektuar.

Në çdo parlament, në Francë në Britani, deputeti flet dhe shpreh mendime totalisht të kundërta me kundërshtarin politik dhe deputetët e dëgjojnë deri në fund. Ky është minimumi i etikës. Në qoftë se ju nuk keni respekt për deputetët, kolegët tuaj të opozitës këtu, çfarë respekti do të keni ju për mediet?!

Më lejoni ta mbaroj deri në fund, ju pëlqen, apo nuk ju pëlqen. Në qoftë se nuk ju pëlqen, ngrihuni dhe dilni!

Ku është problemi me terrenin neotoman shqiptar politik, i nderuar Bashkim European, Këshilli i Europës, OSBE dhe OKB?! Problemi është që Kryeministri, i cili sillet si bajraktar, dhe nuk po flas vetëm për zotin Rama, (Kryeministri e cilësoj si institucion) vjen nga një parti politike, e cila sot quhet Partia Socialiste. Jemi në një terren, ku fjala e lirë brenda partive politike sot është totalisht e kontrolluar dhe e cunguar me një diktat autoritar nga koka. Pra, shkojmë nga Partia Socialiste te Kryeministri. Kryeministri ka kanalën e tij mediatik, i cili quhet ERTV. Nuk e di a e rregullon ky propozim ERTV-në dhe aktivitetin e ERTV-së. Çfarë ndodh tipikisht?!? Pronari ERTV-së, njëkohësisht edhe pronari i PS-së, sjell nisma ligjore në parlament. Zoti Manja, me të drejtë ndoshta, bëri një lapsus Frojdian, por, në fakt, tha një të vërtetë që mua më pëlqen ta citoj këtu: “Produkti që na është kërkuar të votojmë në Kuvend”. Tani unë dua ta keqinterpretoj këtë në interes politik, kuptohet, edhe të opozitës, sepse tipikisht çfarë ndodh në parlament? Deputetëve u kërkohet të votojnë projektligje që vijnë si një lugë e mbushur me çorbë nga Këshilli i Ministrave ose nga Kryeministri. Tani që të kthehemi tek terreni. Personalisht, jam në favor të një sistemi britanik i cikli ka një *Offcom* të pavarur, i cili rregullon medien dhe etikën e medias qoftë audivizive, qoftë e shkruara, qoftë *online*. Nga ana tjetër, është shumë i kujdesshëm për të respektuar të drejtat e njeriut, sidomos kur këto cenohen nga kontenti medieve. Ku është problemi në Shqipëri dhe ku e shikoj unë problemin sot me

këto dy propozimet?! Ne nuk kemi një *Offcom* në Shqipëri dhe besoj se nuk do ta kemi për shumë vjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, i nderuar zoti Kryetar, por AMA nuk është *Offcom*-i dhe është milje dhe shekuj larg *Offcom*-it në mënyrën se si e ushtron, në mënyrën se si emërohen anëtarët, në mënyrën se si ju si kryetar emëroheni, sepse është një institucion, në gjykimin tim si qytetar, por edhe si deputet i Kuvendit të Shqipërisë tërësisht i politizuar dhe nën kontrollin politik dhe, si i tillë, nuk mund të ushtrojë dot rolin e një gjyqësori për të rregulluar medien dhe kontentin e medieve. Ky është opinionimi im. Unë mendoj se “Paketa antishpifje” që paradoksisht asnjë medie (më duket se *Euronews*-i është i pranishëm në këto momente, sepse ky është paradoksi qesharak tjetër i kësaj pakete) nuk është prezente këtu.

Unë e ndaj shqetësimin maxhorancës, pavarësisht kritikave që kam për Partinë Socialiste. Shqipëria ka nevojë për një rregullim të territorit medietik, duke filluar që nga transparenca e pronësisë medietike që, në opinionin tim, është një nga aspektet më problematike të terrenit medietik në Shqipëri. Kemi të bëjmë me pronarë dhe me interesa jashtëzakonisht oligarkike që influencojnë kontentin dhe mënyrën se si përdoret media. Nëse ne sot do të kishim një *Offcom* britanik në Shqipëri, gjysma e medias nuk do të ekzistonte, do të ishin mbyllur minimumi gjysma e medias dhe kjo përfshin ato me shkrim, print, audiovizive dhe *online*, sepse mediet janë të angazhuara në përbaltje të individëve në shkelje totale të të drejtave të njeriut, në përbaltje të deputetëve, të përfaqësuesve politikë, qofshin të opozitës, qofshin të amxhorancës, akuza të ndërsjella nga të dyja anët të pabazuars në fakte, por vetëm në trillime, në sajesa totale dhe nuk ka asnjë autoritet që t’i kontrollojë dhe t’u vërë sanksione. Pra, këtu kemi një problem. Problemi është a jeni ju në gjendje si institucione ndërkombëtare ta ndihmoni qeverinë shqiptare dhe të na ndihmoni ne në parlament që të draftojmë një paketë *libele law* të stilit britanik apo të një vendi tjetër anëtar të Bashkimit Europian, me qëllim që ne si deputetë të opozitës të jemi edhe më të angazhuar për të dhënë ndihmën dhe kontributin tonë që të rregullojmë terrenin medietik shqiptar për dekadat që vijnë?

Së fundi, dua të them më vjen keq, zoti kryetar dhe nuk e kuptoj pse, ndoshta e kam gabim në këtë koment, por unë do të kisha preferuar që të paktën një prej relatorëve të ishte nga opozita në parlament. Pra, për mua, personalisht, e gjithë përjasja procedurale, sepse djalli fle në detaje, është për të përmbushur dëshirat personale të një individi politik, i cili e shikon parlamentin si vegël në funksion të partisë së tij politike.

Dua të siguroj përfaqësuesit e BE-së dhe të OSBE-së që ne, si deputetë të opozitës, jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë me ju, me qëllim që t’i ngremë sa më shumë shqetësimet tuaja,

sepse nuk besoj se ne duhet të miratojmë një “Paketë antishpifje” pa qenë 100% e certifikuar nga Këshilli i Europës, nga OSBE-ja dhe nga Bashkimi European. Kjo është e panegociueshme për ne si deputetë të opozitës. Kështu që dua t’ju falënderoj shumë për ato që kam dëgjuar nga ju, i kam marrë shënim dhe dua që të na i dërgoni edhe me shkrim. Ndoshta të zhvillojmë edhe një takim veçantë me deputetët e opozitës, sepse jemi shumë pak, jemi të cunguar edhe nga ana profesionale, nuk kemi shumë asete në dispozicion dhe kemi nevojë për konsultime me ju, me qëllim që edhe kontributi ynë në parlament të jetë më cilësor në funksion të kësaj “Pakete antishpifje”, të cilën unë parimisht si princip, si koncept për rregullimin e medias nuk e kundërshtoj.

Faleminderit, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Absolutisht, ne e mirëpresim kontributin e opozitës. Jemi të hapur të kemi edhe një relator nga ana e opozitës. Në mbledhjen e radhës jeni i lutur të na jepni emrin se kush do të jetë relator nga ana e opozitës që t’i bashkohet grupit të relatorëve, e lejon Rregullorja e Kuvendit. Absolutisht, ka qenë një praktikë që është ndjekur në Komisionin e Ligjeve, pra, sa herë që opozita kërkon që të jetë kontributore edhe në nivel të relatorëve, është e mirëpritur. Kjo është për atë shqetësim që ju ngritët.

Ndërsa për nismën, mua më vjen mirë që kolegu Gjoni, edhe në emër të opozitës, dhe këtu biem dakord besoj, është parimisht dakord që kërkohet një rregullim i terrenit medietik në Shqipëri.

Së pari, kjo “Paketë antishpifje” reflekton shqetësimet e qytetarëve shqiptarë, pra të shoqërisë shqiptare dhe është përgjegjësia jonë t’i adresojmë, por me zotin Gjoni ndahemi te mentaliteti otoman i shoqërisë shqiptare dhe këtu sigurisht që ndahemi, sepse 98% e shqiptarëve në të gjitha sondazhet në mënyrë konstante janë pro hyrjes në Bashkimin European. Kjo paketë që po bëjmë, sigurisht, ka marrë këtë vëmendje, sepse ne duam të kemi në fuqi dhe duam të miratojmë një paketë që përafrohet me legjislacionin e Bashkimit European dhe me standardet më të mira të lirisë së medias. Për shkak se në Shqipëri ekziston, ndoshta në mënyrë sporadike, ky mentalitet otoman i përdorimit të lirisë së medieve për të hedhur baltë mbi këdo dhe mbi gjithçka, sigurisht që kemi ardhur edhe me shqetësimin për të pasur një paketë antishpifje bashkohore. Gjithsesi, mirëpres çdo kontribut. Sot ishte dita e parë e dëgjesave. Në ditët në vazhdim, në mos gaboj, duke filluar që nesër, kemi dëgjesat e radhës. E thashë që në fillim që jemi komision për dhënie mendimi, ndërsa komision përgjegjës është Komisioni i Medieve, që, fatmirësisht, drejtohet nga opozita, ku opozita do të ketë vulën e fundit në miratimin e këtyre dy projektligjeve, përpara se të kalojë në seancë plenare, por arsyeja që ne

i kërkuam këto dy projektligje me këmbëngulje të jenë në Komisionin e Ligjeve është se pranë këtij komisioni është Nënkomisioni i të Drejtave të Njeriut, të cilin e drejton kolegja Vasilika Hysi që është njëkohësisht edhe bashkërelatore e këtyre dy projektligjeve. Unë jam i bindur që qoftë zonja Hysi, qoftë zonja Bushka kanë të gjithë predispozitën për t'i trajtuar si duhet këto dy projektligje dhe më lejoni t'i falënderoj për kontributin që japin. Ndoshta në nivelin e Komisionit të Ligjeve është ekspertiza e duhur që kanë këto dy projektligje, përpara se ne t'i votojmë në seancën plenare.

Unë ju ftoj që të jeni deri në fund bashkëpunues me relatorët, por edhe me Komisionin e Ligjeve në këtë fazë të diskutimit të këtyre dy projektligjeve dhe ju ftoj që t'i depozitoni sugjerimet që keni sot, por edhe në të ardhmen në sekretarinë e komisionit.

Zonja Hysi, për shkak edhe të një angazhimi tjetër që kemi besoj me një grup tjetër pune për një projektligj shumë të rëndësishëm, atë të pronave, që është një projektligj që meriton vëmendjen e këtij komisioni, dua ta mbyll këtu mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Falënderoj kolegët e mi deputetë, të ftuarit, përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, të partnerëve ndërkombëtarë dhe të operatorëve medietikë, mediet e pranishme për pasqyrimin e kësaj seance, dhe këtu bashkohem me kolegun Gjoni që duhet ta ndjekin me vëmendje diskutimin e këtyre dy projektligjeve!

Dua të falënderoj edhe përfaqësuesit e delegacionit të BE-së, të Këshillit të Europës, të AMA-s, të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, të UNDP-së, të USAID-it, por edhe përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, si dhe të gjithë gazetarët e pranishëm në sallë, por edhe të ftuarit!

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA